



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
KRYETARI

Adresa: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", nr. 3, Tiranë; Tel-Fax: 04-228485

Nr. 863/5 Prot.

Tiranë, më 19/12 /2016

V E N D I M

Nr. 146, Datë 19/12/2016

PËR
EVADIMIN E MATERIALEVE TË AUDITIMIT FINANCIAR TË USHTRUAR MBI
PROGRAMIN E NDIHMËS EKONOMIKE NË PROJEKTIN "MODERNIZIMI I
ASISTENCËS SOCIALE" NË MINISTRINË E MIRËQENIES SOCIALE DHE
RINISË

Pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe projektvendimin e paraqitur nga Grupi i Auditimit të Departamentit të Auditimit të Investimeve dhe Projekteve me Financime të Huaja dhe Shoqërive Publike, shpjegimet e dhëna nga subjekti i audituar, mendimin për cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit Juridik, Kontrollit dhe Zbatimit të Standardeve, vlerësimin mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit të Auditimit të mësipërm dhe Sekretari i Përgjithshëm, në mbështetje të nenit 10, 15, 25 dhe 30 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "*Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*",

V E N D O S A:

- I.** Të miratoj Raportin Përfundimtar të Auditimit "Mbi raportimin financiar dhe përgatitja e pasqyrave financiare për projektin "*Modernizimi i asistencës sociale*", për programin e Ndhmës Ekonomike", në Ministrinë e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, për periudhën 01.01.2015 deri 31.12.2015.
- II.** Të miratoj opinionin dhe rekomandimet e përcaktuara në këtë Raport dhe të kërkoj marrjen e masave, për sa vijon:

A. OPINIONI I AUDITIMIT.

Kontrolli i Lartë i Shtetit ka audituar Raportet Financiare Vjetore të Programit Ndhma Ekonomike (NE), të përgatitura nga Projekti "*Modernizimi i Asistencës Sociale*" në Ministrinë e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë për periudhën 1 Janar 2015 – 31 Dhjetor 2015. Kontrolli i Lartë i Shtetit (KLSH) raporton një opinion për vërtetësinë dhe saktësinë e pasqyrave financiare. Ekzaminimi i Raporteve Financiare për vitin 2015, është ndërmarrë në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtarisht për Institucionet Supreme të Auditimit ISSAI 1000-2999, të INTOSAI-t, ISSAI 200, ISSAI 300 dhe ISSAI 400 si dhe Standardet Ndërkombëtare të Auditimit, SNA, duke fokusuar veprimtarinë në transaksionet financiare të

kryera nën Programin e Ndhmës Ekonomike si dhe menaxhimin financiar dhe kontrollin lidhur me fondet e lëvruara nën këtë komponent. Mbështetur në këto Standarde ky auditim është planifikuar dhe kryer duke arritur siguri të arsyeshme që pasqyrat dhe raportet financiare nuk përmbajnë gabime materiale.

Auditimi i Programit të Ndhmës Ekonomike u realizua me përzgjedhje të transaksioneve, evidencës mbështetëse dhe gjendjeve të llogarive të paraqitura në Raportin Financiar të Vitit 2015. Auditimi përfshin vlerësimin e parimeve të kontabilitetit dhe raportimit financiar të përdorura po ashtu dhe pasqyrimin e deklaratave financiare në përgjithësi.

Për komponentin e parë të Projektit, si rezultat i mosrealizimit në kohë të disa indikatorëve, referuar marrëveshjes së ratifikuar dhe Manualit Operacional të Projektit, që nënkuptojnë objektivat që lidhen me disbursimet, nuk janë kryer pagesat (transhet) të cilat ishin parashikuar të jepen sipas realizimit kohor të indikatorëve. Mos realizimi i indikatorëve përveç efektit financiar (pagesat, transhet) ka ndikuar edhe në arritjen e qëllimit të këtij projekti; *i cili do të mbështesë reformat duke promovuar drejtësinë dhe efikasitetin e përfitimeve të asistencës sociale për familjet dhe individët në nevojë, të cilët nuk mund të sigurojnë plotësimin e nevojave jetike bazë, për shkak të aftësive dhe mundësive të kufizuara social ekonomike.*

Bazuar në auditimin e Projekt-vendimeve të Këshillave Bashkiakë me propozimet për familjet që përfitojnë NE, vendimet e Drejtorive Rajonale me familjet përfituese, urdhër shpenzimet sipas listës së përfituesve, kontabilizimi i tyre në ditarin përkatës, aktrakordimet përfundimtare për vitin 2015 mbajtur midis Bashkive dhe Degëve të Thesarit përkatës me shumat e NE dhe PAK;

Auditimi mbi “Programin e Ndhmës Ekonomike” siguron një bazë të arsyeshme, sikurse është trajtuar në Raportin Përfundimtar, për opinionin e auditimit si më poshtë:

Opinion i Pakualifikuar:

Sipas opinionit tonë Pasqyrat Financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale. (Standardet Ndërkombëtare të Auditimit nr. 200)

Ekzaminimi i pasqyrave vjetore financiare merr parasysh cilësinë dhe saktësinë e informacioneve të regjistruara në raportet financiare si dhe pajtueshmërinë me kornizën raportuese.

Nga auditimi u konstatua se informacionet sipas Raportit Financiar Vjetor 2015 janë korrekte dhe paraqesin në mënyrë të drejtë dhe të saktë aktivitetet financiare të kryera nën Programin e Ndhmës Ekonomike, *për periudhën objekt auditimi 1 janar – 31 Dhjetor 2015, përfshijnë shumën 4,486,005 mijë lekë.*

B. MASA ORGANIZATIVE.

1. Gjetje nga auditimi:

Me Marrëveshjen e Huasë, disbursimet për Komponentin e parë kushtëzohen nga arritja e Indikatorëve të Disbursimit në çdo kohë, gjatë periudhës së programit. Në total janë vendosur 17 indikatorë, kundrejt të cilëve do të matet performanca e Projektit dhe do të realizohet mbështetja financiare nga donatori.

Indikatorët që lidhen me disbursimet e planifikuar, sipas Projekt Dokumentit të Vlerësimit dhe Manualit Operacional të Projektit, për tu realizuar deri në vitin 2015, janë 12 me vlerën 26,125,000 Euro. Nga këta indikatorë të parashikuar nuk janë realizuar 5 (pesë) me një vlerë disbursimi prej **11,590,000 Euro**.

13/2014: Faza e parë e MIS (Sistemi i Menaxhimit të Informacionit), PAK është zhvilluar dhe testuar, duke përfshirë module funksionale për një regjistër kombëtar të aplikantëve të

rinj dhe përfituesit ekzistues të PAK, vlerësimi për pranueshmërinë e tyre, ricertifikimi, futja në program, nxjerrja e urdhërpagesave dhe raportimin. *Shuma për disbursim 2,090,000 euro.*

4/2015: Të paktën 80 % e familjeve në nivel kombëtar, të cilat po marrin përfitimet për programin e NE janë kontrolluar për pranueshmërinë e tyre duke përdorur formulën e unifikuar të pikëzimit për të cilën është rënë dakord me Bankën. *Shuma për disbursim 1,900,000 euro.*

6/2015: Kriteret e vlerësimit, procedurat e biznesit dhe marrëveshjet institucionale për PAK janë rishikuar bazuar në modelin social dhe këto rishikime janë konsultuar, miratuar dhe shpërndarë. *Shuma për disbursim 1,900,000 euro.*

11/2015: Të paktën 90 % e njërive të pushtetit vendor (*bashki/komuna*) në nivel kombëtar përdorin MIS NE për të përpunuar regjistrimin e aplikantëve, përzgjedhjen e përfituesve, hyrjen në program dhe urdhërpagesat e NE; dhe MIS NE është zgjeruar për të mbuluar funksionet e fazës së dytë, duke përfshirë një modul të informacionit të biznesit për monitorim dhe vlerësim. *Shuma për disbursim 2,850,000 euro.*

14/2015: Të paktën 90 % e njërive të pushtetit vendor (*bashki/komuna*) në 2 rajonet pilote, të përzgjedhura në konsultim me Bankën, përdorin MIS PAK të automatizuar për të përpunuar regjistrimin e aplikantëve të rinj të PAK dhe futjen në program; për regjistrimin e vendimeve të ricertifikimit për përfituesit ekzistues; dhe për nxjerrjen e urdhërpagesave për përfituesit e rinj dhe ata ekzistues. *Shuma për disbursim 2,850,000 euro.*

Për komponentin e parë të Projektit, si rezultat i mosrealizimit në kohë të disa indikatorëve, referuar marrëveshjes së ratifikuar dhe Manualin Operacional të Projektit, nuk janë kryer pagesat (*transhet*) të cilat ishin parashikuar të jepen sipas realizimit kohor të indikatorëve.

Për sa më sipër, trajtuar më hollësisht në faqet nr. 13-22, të Raportit Përfundimtar të Auditimit, [rekomandojmë:](#)

Nga MMSR, të merren masat për realizimin e indikatorëve të planifikuar, për të mundësuar kryerjen e pagesave, të cilat ishin parashikuar të jepen sipas realizimit kohor të tyre, për të eliminuar efektin financiar që sjell mosrealizimi (pagesat, transhet) dhe arritjen e qëllimit të këtij projekti, në mbështetje të reformave për asistencën sociale për familjet dhe individët në nevojë.

Në vijimësi.

2. Gjetje nga auditimi:

MMRS duke mos pasur akses të drejtpërdrejtë në sistemin e thesarit, ka kërkuar mbështetjen e Ministrisë së Financave, Drejtorisë së Përgjithshme të Thesarit e cila ka dërguar raportet financiare mbi ekzekutimin e buxhetit për NE dhe PAK për periudhën janar - dhjetor 2015, sipas të dhënave të gjeneruara nga sistemi i thesarit të cilat nuk janë të detajuara dhe me ndarje të saktë (NE, PAK).

Nga auditimi i pasqyrave financiare në Njësitë e Pushtetit Vendor, Akt – Rakordimeve me Degët e Thesarit, rezultoi se shpenzimet për “*Transferta e popullsisë dhe individëve*” korrespondojnë me vlerat e urdhër shpenzimeve për Programin e Ndihmës Ekonomike dhe Pagesat e Paaftësisë.

Për sa më sipër, trajtuar më hollësisht në faqet nr. 22-28, të Raportit Përfundimtar të Auditimit, [rekomandojmë:](#)

- *MMSR, Njësia e Zbatimit të Projektit në përgatitjen e Raporteve Financiare (NE, PAK) për komponentin 1 të projektit i cili paraqitet zyrtarisht në Bankën Botërore, të mbështetet në situacionet e shpenzimeve të kryera për vitin ushtrimor nga njësitë e pushtetit vendor të rakorduara me Degët e Thesarit përkatës.*

Në vijimësi.

3. Gjetje nga auditimi:

Nga Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë dhe Shërbimi Social Shtetëror (SHSSH), hartimi i planit buxhetor, detajimi i tij në nivel vjetor dhe limite mujore për të gjithë institucionet e vartësisë, deri në nivel artikulli si dhe fondet e mbrojtjes sociale ndihmë Ekonomike dhe PAK për të gjitha njësitë e pushtetit vendor bazohet në të dhënat statistikore mujore, vjetore por jo edhe në realizimin faktik të NE dhe PAK.

Gjithashtu çelja e fondeve nuk bëhet i detajuar për çdo program, Ndihma Ekonomike dhe Pagesat e Aftësisë së Kufizuar më vete dhe të dërgohet e detajuar në degët e thesarit në rrethe dhe njëkohësisht në njësitë e qeverisjes vendore, gjë që sjell një menaxhim jo efektiv të fondeve dhe përdorimin e tyre sipas qëllimit për të cilin janë akorduar.

Për sa më sipër, trajtuar më hollësisht në faqet nr. 22-28, të Raportit Përfundimtar të Auditimit, [rekomandojmë](#):

-Ministria e Financave në bashkëpunim me Shërbimin Social Shtetëror, me qëllim mirë menaxhimin e fondeve dhe përdorimin e tyre sipas qëllimit për të cilin janë akorduar, të vendosin mekanizma të shkëmbimit të informacionit të detajuar në nivel të qeverisjes vendore. Kjo do të kërkojë që çelja e fondeve të behët e detajuar për çdo program, NE dhe PAK me vete, dhe të dërgohet e detajuar në degët e thesarit në rrethe dhe njëkohësisht në njësitë e qeverisjes vendore.

Në vijimësi.

4. Gjetje nga auditimi:

Në Raportet Tremujore dhe Vjetore, drejtuar BB, mungojnë raportet e monitorimit dhe vlerësimit të aktiviteteve të projektit, rezultateve/arritjeve në përputhje me kuadrin e përshkruar në PAD (*Dokumenti i Vlerësimit të Projektit*) sipas Aneksi I – Korniza e Rezultateve & Monitorimit.

Gjithashtu, në Raportin Vjetor të Progresit të Projektit, informacioni nuk ka një analizë të detajuar të aktivitetit të projektit, statusin e zbatimit dhe vlerësimi mbi progresin e projektit SAMP në arritjen e objektivave të zhvillimit.

Për sa më sipër, trajtuar më hollësisht në faqet nr. 22-28, të Raportit Përfundimtar të Auditimit, [rekomandojmë](#):

*- Nga Njësia e Zbatimit të Projektit të merren masa që, Raportet Tremujore dhe Vjetore të Progresit të Projektit, të shoqërohen me një raport monitorimi dhe vlerësimi të aktiviteteve të projektit, arritjeve në përputhje me kuadrin e përshkruar në PAD.
Raportet Vjetore të Progresit të Projektit, të pasqyrojnë një informacion më të detajuar mbi analizën e aktivitetit të projektit, statusin e zbatimit të tyre dhe vlerësimin mbi progresin e projektit SAMP në arritjen e objektivave të zhvillimit të formuluar në PAD.*

Në vijimësi.

5. Gjetje nga auditimi:

Bazuar në këto propozim vendimet e paraqitura nga Këshillat Bashkiake, Zyrat Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror, kanë vendosur për familjet të cilët përfitojnë ndihmë ekonomike, duke përcaktuar fondin përkatës, si dhe individë me statusin e jetimit, individë viktimë të trafikimit, individë viktimë të dhunës në familje, individë prindër të fëmijëve të lindur trinjakë, katërnjakë, pesënjakë etj. Gjithashtu në këto vendime janë përcaktuar edhe familjet e propozuara të cilat nuk përfitojnë ndihmë ekonomike me arsyet e daljes nga skema si “individë me automjet”, “pensionistë”, “deklarim i rremë” dhe “nuk ka marrë pikët e mjaftueshme”, etj.

Përcaktimi “nuk kanë marrë pikët e mjaftueshme” nga sistemi i TI për “*Modernizimin e Asistencës Sociale*”, si arsye për daljen nga skema e NE, është e pa përcaktuar dhe me asnjë argument se çfarë kuptohet, çfarë nuk plotëson aplikanti për të mos përfituar Ndhmë Ekonomike, gjë që sjell vështirësi për përfaqësuesit e Zyrave të Shërbimit Social Shtetëror pranë Njërive Vendore në sqarimin e aplikantëve, duke krijuar paqartësi në ushtrimin e funksionit si dhe informimin e publikut.

Për sa më sipër, trajtuar më hollësisht në faqet nr. 28-37, të Raportit Përfundimtar të Auditimit, [rekomandojmë:](#)

Nga MMSR të merren masa që Sistemi i Menaxhimit të Informacionit Elektronik, (sistemi i TI) krahas vendimit të Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror me familjet përfituese dhe ato të përjashtuara, duhet të nxjerrë dhe ta shoqërojë këtë vendim me shtojcën tre, të plotësuar me treguesit e vlerësimit sipas sistemit të formulës së pikëzimit, në përputhje me VKM nr. 904, datë 12.12.2012 “Për përcaktimin e kritereve, të procedurave dhe dokumentacionit të përfitimit të ndihmës ekonomike në zonat pilot”.

Në vijimësi

6. Gjetje nga auditimi:

Sistemi i Menaxhimit të Informacionit elektronik aktual nuk nxjerr në mënyrë të automatizuar dhe raportin e “*Regjistrin Elektronik të Përfituesve*”, por nxjerr vetëm listën e përfituesve sipas emrave të kryefamiljarëve. Ky regjistër, rezulton se mbahet në mënyrë manuale duke shkaktuar mospërputhje midis vendimit të Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror, sipas të cilit në listat e përfituesve të nxjerra si raport nga sistemi vihen kryefamiljarët dhe VKM nr. 904, datë 12.12.2012 “*Për përcaktimin e kritereve, të procedurave dhe dokumentacionit të përfitimit të ndihmës ekonomike në zonat pilot*”, të ndryshuar, ku personat që duhet të tërheqin ndihmën ekonomike janë bashkëshortet gra, konstatuar edhe për vitin 2014 dhe i pa reflektuar.

Për sa më sipër, trajtuar më hollësisht në faqet nr. 28-37, të Raportit Përfundimtar të Auditimit, [rekomandojmë:](#)

Nga MMSR, të merren masat për implementimin e ndryshimeve në programin e informatizuar të Ndhmës Ekonomike, për të gjeneruar Raportin e Regjistrin të Përfituesve të Ndhmës Ekonomike (jo vetëm listat e përfituesve) dhe në Raportin e listave të përfituesve duhet të vihen bashkëlidhur emrit të kryefamiljarit dhe emrat e bashkëshorteve të tyre.

MMSR, SHSSH nëpërmjet regjistrin të NE të ushtrojnë kontrollet e kryqëzuara, e informacionit mbi familjen dhe/ose individin me sistemet e informacionit të institucioneve të tjera që përmbajnë të dhëna tatimore, punësimit, automjeteve, gjendjes civile, apo regjistrimi të bizneseve duke përshpejtuar, ulur kostot e procesit të kontrollit të situatës ekonomike të aplikuesve dhe mundësinë e abuzimit me skemën e Ndhmës Ekonomike.

Në vijimësi.

7. Gjetje nga auditimi:

Në njësitë vendore nga auditimi i dosjeve të përfituesve të NE, vendimet e Zyrave Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror nuk shoqërohen me informacionin për kushtëzimin e dhënies së NE me punë dhe shërbim në komunitet në zbatim të kërkesave të VKM nr. 1053, datë 23.04.2008, “*Për disa ndryshime në Vendimin nr. 787, dt. 14.12.2005 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e kritereve, të procedurave dhe të masës së ndihmës ekonomike”* Kreu IV, pika 27.

Për sa më sipër, trajtuar më hollësisht në faqet nr. 28-37, të Raportit Përfundimtar të Auditimit, **rekomandojmë:**

-Nga MMSR dhe SHSSH të sigurohet një bashkëpunimin efektiv me Njësitë e Pushtetit Vendor, Shërbimin Kombëtar të Punës, nëpërmjet njohjes së proceseve të punës së secilit prej institucioneve, me qëllim nxitjen e punësimit, dhe për të përmirësuar rekordet që mbahen nga SHKP kur përfituesit e ndihmës ekonomike refuzojnë vendin e punës.

Në vijimësi.

8. Gjetje nga auditimi:

Nga auditimi në bashkitë, Kamzë, Shijak, Vorë, rezultoi se urdhër shpenzimet për pagesat e ndihmës ekonomike, nuk kanë bashkëlidhur dokumentacionin përkatës justifikues të domosdoshëm si; Vendimet e Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social me emrat e familjeve përfituese ose jo, listë pagesat të miratuara nga titullari, kjo në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 30, dt. 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

Plotësimi i dosjeve të aplikantëve vazhdon të bazohet në “dokumente zyrtare”, kur verifikimi i pjesës më të madhe të këtyre të dhënave dokumentare bëhet nga sistemi elektronik dhe nëpërmjet përdorimit të formulës së pikëzuar vlerësohet situata ekonomike e familjeve në nevojë, tej zgjat procesin, rrit volumin e dokumenteve të kërkuara, dhe pamundëson ruajtjen e tyre.

Për sa më sipër, trajtuar më hollësisht në faqet nr. 28-37, të Raportit Përfundimtar të Auditimit, **rekomandojmë:**

MMSR dhe SHSSH në zbatim të skemës së re të ndihmës ekonomike, për plotësimin e dosjes të aplikantëve të marrin masat dhe të synojnë drejt zbatimit të sistemit i cili mundëson verifikimin automatik të dokumentacionit që familjet në nevojë do të duhet të paraqesin dhe që nuk bazohet në “dokumente zyrtare”, si një mënyrë për të reduktuar volumin e dokumenteve të kërkuara dhe lehtësuar procedurën e përfitimit të ndihmës ekonomike.

Në vijimësi.

9. Gjetje nga auditimi:

Në zbatim të Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit ISSAI 1600 “Përdorimi i punës së një eksperti auditimi”¹, grupi i auditimit përdor materialin e auditimit ushtruar nga Drejtoria e Kontrollit të NE dhe Pagesës PAK pranë SHSSH për vitin 2015, me objekt auditimi zbatimin e legjislacionit të NE-së.

a. Nga kontrollet e ushtruara nga SHSSH, Drejtoria e Kontrollit të NE dhe Pagesës PAK për vitin 2015 në Drejtorinë Rajonale të Shërbimit Social dhe në njësitë e qeverisjes vendore ka rezultuar:

Janë konstatuar 187 familje abuzive të cilat janë larguar nga skema e NE, me dëm ekonomik 1,153,127 lekë. Gjithashtu janë paguar më tepër 11 familje, në kundërshtim me Udhëzimin nr. 338/3 duke shkaktuar një efekt financiar prej 76,940 lekë (arkëtim shume). Njësitë e qeverisjes vendore (deri 10% e tyre) nuk dorëzojnë pranë drejtorisë rajonale projekt-vendimet, vendimet dhe evidencat në afat siç përcaktohet në legjislacionin në fuqi. Masat e lëna nga Drejtorinë Rajonale në lidhje me arkëtimin e shumave nuk janë zbatuar nga 70% e njësive vendore. Pagesa me përqindje e NE, është kryer duke shkelur pikën 18 të VKM nr. 787, dt. 14.12.2005 në lidhje me llogaritjen dhe dhënien e masës së përfitimit të ndihmës ekonomike. Pothuajse në të gjitha njësitë vendore nuk zbatohet VKM nr. 1053, datë 23.04.2008, Kreu IV, pika 27, për kushtëzimin e dhënies së NE me punë dhe shërbim në

¹Mbështetur në ISSAI 1600 “Përdorimi i punës së Audituesve të Brendshëm”

komunitet. Akt-verifikimet mbi situatën reale social-ekonomike, nuk kryhen dy herë në vit për të gjitha familjet përfituese, kjo në kundërshtim me ligjin nr. 9355, datë 10.03.2005 neni 31 pika b. Listat e përfituesve të ndihmës ekonomike nuk afishohen siç është përcaktuar në vendimin përkatës. Nuk janë realizuar plotësisht detyrat e lëna nga kontrollet e mëparshme lidhur me arkëtimin e shumës së përfituar padrejtësisht, duke ndikuar kështu në rritjen e efekteve financiare.

b. Për familjet e reja që futen në skemën e NE ka rezultuar:

Vendimmarrja për këto familje bëhet pa bërë verifikimin e menjëhershëm social-ekonomik nga administratori shoqëror si dhe formulari i vizitës në familje nuk përkon me VKM nr. 904, dt. 12.12.2012 “Për përcaktimin e kritereve, të procedurave dhe dokumentacionit të përfitimit të ndihmës ekonomike, në zonat pilot”. Ka raste kur një aplikues gjatë verifikimit automatik nga institucionet rezulton disa here me deklaratë të rreme si dhe janë identifikuar individë të cilët kanë aplikuar disa herë duke ndryshuar të dhënat në aplikim herë pas here. Vendimi final për trajtimin e familjeve me NE nuk dërgohet nga Bashkitë pranë njësive administrative, me qëllim afishimin e listave të familjeve përfituese dhe jo përfituese me arsyet përkatëse.

*Për sa më sipër, trajtuar më hollësisht në faqet nr. 28-37, të Raportit Përfundimtar të Auditimit, **rekomandojmë:***

- *MMSR të marrë masa dhe të parashikojë në legjislacionin e NE afatet kohore të detyrueshme që duhet respektuar nga administratori shoqëror në lidhje me verifikimet social-ekonomike për hyrjet e reja.*
- *MMSR të rishikojë formatin e formularit të vizitës në familje pasi nuk përkon me përcaktimet e VKM nr. 904, dt. 12.12.2012 “Për përcaktimin e kritereve, të procedurave dhe dokumentacionit të përfitimit të ndihmës ekonomike, në zonat pilot”.*
- *Për rastet me deklarime të rreme, sistemi elektronik duhet të gjenerojë të dhëna për Drejtorinë Rajonale për të dhënë mundësinë e kontrollit nëse ky është rast abuziv.*

Në vijimësi.

c. Nga kontrollet e ushtruara nga Drejtoritë Rajonale të Shërbimit Social Tiranë, Elbasan dhe Durrës për vitin 2015 në njësitë e qeverisjes vendore ka rezultuar:

Si rezultat i verifikimeve social-ekonomike janë konstatuar mospërputhje me deklarinimin 125 familje të cilat janë larguar nga skema duke shkaktuar dëm ekonomik në vlerën 3,655,570 lekë. Formulari i vizitës në familje në 20% të rasteve është plotësuar në mënyrë fiktive dhe jo i plotë. Pjesa më e madhe familje përfituese të NE në ish-komuna nuk kanë në dosje certifikatën e pronësisë mbi tokën të lëshuar nga ZRPP, apo aktin e marrjes së tokës në pronësi, megjithëse në sistem kanë deklaruar sasinë e tokës. Në Njësitë Administrative nuk afishohen listat e përfituesve të NE.

*Për sa më sipër, trajtuar më hollësisht në faqet nr. 28-37, të Raportit Përfundimtar të Auditimit, **rekomandojmë:***

Nga Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Shërbimi Social Shtetëror:

- *Në bashkëpunim me Ministrinë e Financave të mundësohet parashikimi i një mekanizmi për rastet e kthimit të shumave të përfituara në mënyrë të padrejtë nga familjet përfituese.*
- *Të merren masa për përmirësimin e verifikimeve automatike nëpërmjet përmirësimit të sistemit elektronik të institucioneve të tjera në mënyrë që verifikimi i të dhënave të jetë i shpejtë dhe më efektiv.*
- *Të merren masat për kryerjen e kontrollit dhe vlerësimit social-ekonomik për hyrjet e reja dhe 2 herë në vit për të gjithë përfituesit duke shoqëruar atë me*

ngritjen e kapaciteteve të grupit të kontrollit në lidhje me metodologjinë e kontrollit në bazë të vlerësimit të riskut.

- *Të merren masat për ndjekjen e procedurave të ankimimeve nga ana e Drejtorive Rajonale duke bërë vlerësimin social-ekonomik në familje me afate të mirë përcaktuara dhe ofrimin e alternativave të tjera të mundshme për familjet e vlerësuara në nevojë që nuk dalin përfituese nga sistemi i pikëzimit.*

Në vijimësi.

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Investimeve e Projekteve me Financime të Huaja, Shoqërive Publike.

Bujar LESKAJ

K R Y E T A R